



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Përcaktuesit makroekonomikë të  
remitencave në Kosovë: Analizë  
me të dhëna panel**

Esida BUJUPI

Material Studimor Nr. 8



## Material Studimor i BQK-së Nr. 8

### Përcaktuesit makroekonomikë të remitencave në Kosovë: Analizë me të dhëna panel

Esida Bujupi<sup>1</sup>

Konsulente

Departamenti i Analizës Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

#### Abstrakt

Ky punim synon të vlerësojë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të dërgesave të emigrantëve në Kosovë, duke përdorur të dhëna tremujore për periudhën 2004- 2016. Këto dërgesa (apo remitencat, siç njihen ndryshe ne terminologjinë e Metodikës mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave) përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme dhe më të qëndrueshme të financimit të huaj dhe rrjedhimisht identifikimi i përcaktuesve të këtyre flukseve është i nevojshëm. Gjithashtu, ky studim do të ndihmojë në kuantifikimin e ecurisë së ardhshme të remitencave, e cila më tej do të inkorporohet si input në gjenerimin e projeksioneve në modelin makroekonometrik të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (KMM). Përfaqja metodologjike e ndjekur në këtë punim konsiston në të dhëna panel për treguesit kryesorë ekonomikë në Kosovë dhe në 15 vendet nga të cilat origjinojnë remitencat e Kosovës. Punimi gjen se aktiviteti ekonomik në vendet pritëse të emigrantëve kosovarë ka ndikim të rëndësishëm pozitiv në flukset e këtyre emigrantëve. Ndërsa, përsa i përket treguesve të vendit origjinë të emigrantëve, Bruto Produkti Vendor rezulton të jetë i lidhur negativisht me flukset e remitencave duke mbështetur hipotezën e mbizotërimit të motivit të altruizmit tek emigrantët kosovarë, sipas të cilit emigrantët janë më të prirur të dërgojnë remitanca tek familjarët e tyre kur situata ekonomike e tyre përkeqësohet.

Prill, 2018

---

<sup>1</sup> Pikëpamjet dhe gjetjet e shprehura në këtë material studimor janë të autorit dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë ato të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ky punim ka përfituar nga komentet dhe sugjerimet e vlefshme të znj. Zana Gjocaj, znj. Shqipe Hajredini dhe znj. Hana Gafurri (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës).



## PËRMBAJTJA

I. Hyrje-----	7
II. Vështrim mbi literaturën -----	11
III. Përçasja metodologjike dhe modeli empirik -----	14
IV. Konkluzionet dhe implikimet për politikëbërjen -----	16



## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Ecuria e remitancave në Kosovë-----	07
Figura 2. Rëndësia e burimeve të huaja të financimit në Kosovë (% e BPV-së)-----	08
Figura 3. Karakteristikat e burimeve të financimit të huaj-----	08
Figura 4. Ciklikaliteti i Remitencave-----	08
Figura 5. Përbërja e Remitancave sipas origjinës -----	10
Figura 6. Shpërndarja gjeografike e emigrantëve kosovarë -----	10

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rezultatet empirike nga analiza me të dhëna panel -----	16
---	----





## I. Hyrje


Flukset hyrëse të remitencave në Kosovë përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme të financimit të huaj, duke dominuar kështu në diskutimet lidhur me burimet e rritjes ekonomike, zbutjes së hendekut të defiçitit tregtar, uljes së nivelit të varfërisë në vend apo tërheqjes së investimeve të huaja. Kjo vëmendje e madhe kushtuar remitencave i atribuohet kryesisht madhësisë së këtyre prurjeve në raport me Bruto Produktin Vendor, natyrës së tyre të qëndrueshme krahasuar me flukset e tjera të financimit të huaj dhe efektit të tyre zbutës të varfërisë dhe papunësisë në vend.

Gjatë periudhës 2004-2016, remitencat kanë shënuar një normë mesatare rritje vjetore prej rreth 6 përqind, ndonëse ecuria e tyre është subjekt i disa thyerjeve strukturore gjatë kësaj periudhe. Në periudhën 2005-2008, remitencat janë karakterizuar me një normë dyshifrore të rritjes që është luhatur në një interval prej 10 përqind-17 përqind. Ndërsa, në vitet 2009 dhe 2010, remitencat kanë shënuar rënie të lehtë vjetore që kryesisht rezultoi si pasojë e ndikimit të krizës financiare në

vendet ku është e përqendruar diaspora kosovare. Viti 2011 shënoi rënien më të lartë historike të remitencave, me rreth 15 përqind, gjë që i'u atribua ndryshimit të metodologjisë së matjes së remitencave nga Departamenti i Statistikave (Banka Qendrore e Republikës së Kosovës)<sup>2</sup>. Që pas vitit 2011, remitencat janë karakterizuar me një normë rritjeje më të ngadalhtë krahasuar me periudhat e mëparshme prej rreth 7 përqind (figura 1).

Paraqitja grafike e ecurisë së remitencave mbështet teorinë e shumë përmendur në literaturë, sipas së cilës remitencat maturohen me kohën, çka do të thotë se priten të kenë një tendencë rënëse në afat të gjatë si pasojë e ndryshimit të mundshëm të statusit të emigrantëve. Ata mund të krijojnë familje në vendin pritës ose të bashkohen me pjesën tjetër të familjes, çka dobëson lidhjet familjare me vendin e origjinës dhe rrjedhimisht janë më pak të motivuar për të dërguar remitenca (Docquier dhe Rapoport, 2005; dhe IOM, 2005). Më specifikisht, regresioni linear i normës vjetore të rritjes së remitançave mbi termin kohë rezultojn të jetë negativ, siç tregojn edhe figura 1, sipas së cilës norma e rritjes së remitançave shënon rënie me rreth 0.2 pikë përqindje me kalimin e çdo periudhe kohore. Megjithatë, vlera e statistikës *R-squared* është mjaft e ulët, rreth 7 përqind, çka sugjeron se ecuria e remitançave shpjegohet vetëm 7% nga termi kohë ndërsa pjesa tjetër është funksion i treguesve të tjerë. Një panoramë të kundërt jep trendi kohor i remitançave në nivel, sipas të cilit remitançat rriten me rreth 1.16 mln euro çdo tremujor dhe me një shpjegueshmëri më të madhe se në rastin e parë, me rreth 43 përqind. Kombinimi i këtyre trendeve tregon se remitançat me kohën janë rritur por më një normë rritjeje që ngadalësohet me kohën.

Figura 1. Ecuria e remitencave në Kosovë



Burimi: BQK


<sup>2</sup> Në vitin 2016, Departamenti i Statistikave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ka realizuar një anketë me emigrantët kosovarë në pikat kryesore kufitare. Rezultatet e kësaj ankete kanë treguar se emigrantët kur vijnë në Kosovë shpenzojnë më shumë për nevojat e tyre (shërbime të udhëtimeve) duke shfrytëzuar kartelat e tyre bankare se sa për transferata personale tek familjarët e tyre. Ky rishikim i remitencave në një vlerë më të ulët është aplikuar mbrapa në kohë deri në vitin 2011.

Dinamikat e remitencave në vazhdimësi kanë gëzuar vëmendje të veçantë në Kosovë, kryesisht si pasojë e varësisë së ndjeshme të ekonomisë së vendit nga këto dërgesa, të cilat mesatarisht gjatë periudhës së marrë në studim (2004-2016) përbënin rreth 13 përqind të Bruto Produktit Vendor. Kjo varësi mbi këto flukse është e krahasueshme me eksportet totale të Kosovës deri në vitin 2008, ndërkohë që pas këtij viti eksportet kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në BPV në rreth 22 përqind përdërisa varësia nga remitencat luhatet rreth vlerës 12 përqind. Tre burimet e tjera të financimit të huaj (investimet e huaja direkte, të ardhurat dytësore të qeverisë dhe kompensimi i punëtorëve) kanë një peshë më të vogël ndaj BPV-së krahasuar me remitencat (rreth 6.3, 7.5 përkatësisht 4.3 përqind) gjatë periudhës 2004- 2016 (figura 2).

Gjithashtu, remitencat në Kosovë kanë ndikuar në zbutjen e deficitit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, duke e mbuluar atë në një nivel rreth 38 përqind mesatarisht për gjithë periudhën 2004-2016. Në mungesë të këtyre flukseve, deficitin rrjedhës do të luhatej rreth një pjesëmarrjeje prej rreth 20 përqind të BPV-së, nivel ndjeshëm më i lartë se niveli aktual prej 8 përqind, duke përkeqësuar dhe rrezikuar qëndrueshmërinë e bilancit të pagesave. Megjithatë, studime të shumta sugjerojnë se varësia e madhe e një ekonomie mbi remitencat mund të rezultojë në mosadresim të disbalanceve fundamentale, të cilat shkaktojnë ekzistencën e një deficitit të lartë tregtar një ekonomi. Gjithashtu, studimet sugjerojnë që pranimi i rregullt i transfertave të tilla mund të ndikojë në përkeqësimin e dinamikave të tregut të punës, sepse dekurajon familjarët pranues të dërgesave për t'u aktivizuar në tregun e punës, duke u mjaftuar me këto transferta.


Një karakteristikë tjetër e remitencave është se ato rezultojnë të kenë shkallën më të lartë të prociklikalitetit krahasuar me burimet e tjera të financimit, çka do të thotë se korrelacioni i sinkronizuar ndërmjet serisë së BPV-së reale dhe serisë kohore të remitencave, të zhveshura nga trendi kohor, rezulton të jetë pozitiv. Siç tregon figura 3, të gjitha burimet e financimit të huaj rezultojnë të jenë prociklike me aktivitetin ekonomik në vend. Edhe pse ky korrelacion duhet interpretuar me kujdes<sup>3</sup>, shenja pozitive e tij në rastin e remitencave nuk rezulton të jetë në linjë me pritshmërinë apo intuitën ekonomike. Sipas kësaj të fundit, remitencat kryesisht përdoren për qëllime konsumi dhe rrjedhimisht në kushtet e përkeqësimit të të ardhurave (BPV-së) për familjarët e emigrantëve, remitencat duhej të rriteshin për të mbajtur të njëjtin nivel të

Figura 2. Rëndësia e burimeve të huaja të financimit në Kosovë (% e BPV-së)



Burimi: BQK, ASK

Figura 3. Karakteristikat e burimeve të financimit të huaj



Burimi: BQK, ASK

<sup>3</sup> Koefficienti i korrelacionit është një numër që përfaqëson shkallën e bashkë-lëvizjes ndërmjet dy treguesve të ndryshëm, por interpretimi i të cilit has në një sërë vështirësish. Koefficienti i korrelacionit nuk jep asnjë informacion në lidhje me drejtimin e shkakësisë ndërmjet dy treguesve dhe zakonisht është mjaft sensitiv ndaj madhësisë së periudhës kohore mbi të cilën përlogaritet.

konsumit. Megjithatë, ashtu siç tregon figura 4, korrelacioni jo i sinkronizuar ndërmjet komponentit ciklik ndërmjet remitencave në kohën  $t$  dhe BPV-së reale në kohën  $t-1$  rezulton të jetë pothuajse zero ndërsa në kohën  $t-2$  dhe  $t-3$  rezulton të jetë negativ, duke mbështetur faktin që një përkeqësim i aktivitetit ekonomik do të çojë në prurje më të larta në periudhat vijuese, dhe jo në kohën aktuale, sepse emigrantët marrin kohë (2-3 tremujorë sipas analizës së korrelacionit) për të përshtatur financat e tyre personale.


Rëndësia e remitencave për ekonominë e Kosovës është e lidhur ngushtë edhe me qëndrueshmërinë e tyre si flukse hyrëse. Remitenat dhe kompensimi i punëtorëve, bazuar mbi raportin e devijimit standard ndaj mesatares, janë flukset më pak të luhatshme<sup>4</sup>. Ndërkohë, luhatshmëria e eksporteve rezulton të jetë më e larta nga të gjitha burimet e financimit të huaj. Kjo qëndrueshmëri e remitencave krahasuar me flukset e tjera, i bën ato më të përshtatshme dhe më të sigurta gjatë procesit të hartimit apo implementimit të politikave afatgjata zhvillimore (figura 3).

Për një kuptim më të mirë të flukseve hyrëse të remitencave në Kosovë, është e rëndësishme që të kuptohet fenomeni i emigrimit së bashku me karakteristikat kryesore të tij si: valët kryesore të emigrimit, vendet ku kanë emigruar kosovarët, numri i stokut të emigrantëve të lokalizuar në çdo vend, etj.

Një sërë burimesh dhe raportimesh të ndryshme në lidhje me emigracionin në Kosovë tregojnë se emigracioni në Kosovë është një fenomen i hershëm, që daton nga fundi i viteve '60-të dhe karakterizohet nga disa valë kryesore emigrimi.

Faza e parë e emigracionit i takon periudhës 1960-1988, gjatë së cilës emigrantë të pakualifikuar dhe nga pjesët rurale kanë emigruar drejt Gjermanisë dhe Zvicrës me kontratë të përkohshme pune, por që më vonë kanë gjetur mundësi të tërheqin familjet e tyre dhe të qëndrojnë në këto vende për gjenerata. Faza e dytë mbulon periudhën 1989-1997 dhe karakterizohet nga emigrimi i meshkujve të rinj dhe të arsimuar, në përpjekje për t'i shpëtuar shërbimit ushtarak jugosllav. Faza e tretë i përket periudhës së luftës 1998-1999, gjatë së cilës kosovarët kanë qenë të detyruar të emigronin drejt shteteve fqinje, ndonëse pjesa dërrmuese e tyre u rikthye shpejtë. Gjatë periudhës së pasluftës (2000-2007), vlerësohet të ketë pasur edhe një valë emigrimi kryesisht ilegal, për shkak të ashpërsimit të imigracionit të shteteve të tjera ndaj Kosovës si një vend tashmë i sigurt. Vala më e fundit vlerësohet të ketë qenë ajo e vitit 2014 dhe 2015, kur rreth 40,000 përkatësisht 70,000 kosovarë, kanë aplikuar për azil për herë të parë në vendet e Bashkimit Evropian (Eurostat, 2015 dhe 2016), kryesisht për arsye të vështira ekonomike në vendin mëmë.

Figura 4. Ciklikaliteti i Remitencave



Burimi: BQK, ASK

<sup>4</sup> Koefficienti i variacionit, i matur si raport i devijimit standard ndaj mesatares, "kap" ndryshueshmërinë e një kampioni të dhënash në raport me mesataren e vet. Duke qenë se ky koefficient është pa njësi dhe i shprehur në përqindje, është mjaft i dobishëm në krahasimin e kampioneve të ndryshme të dhënash që kanë njësi të ndryshme matje ose që kanë njësi të njëjta matje por që ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në terma të magnitudës.

Burime të ndryshme statistikore japin vlerësime të ndryshme mbi numrin aktual të emigrantëve kosovarë që jetojnë jashtë kufijve shtetërorë, ku raporti i tyre ndaj popullsisë totale që jeton në Kosovë luhet nga 32 përqind deri në 45 përqind. Sipas të dhënave më të fundit të Bankës Botërore (2013), pjesa më e madhe e emigrantëve kosovarë jeton në Gjermani, Zvicër, Itali dhe Slloveni, duke përfaqësuar 35, 27, 8 përqind deri në 7 përqind të stokut total të emigrantëve (figura 5). Kjo shpërndarje gjeografike e emigrantëve kosovarë është në linjë me përbërjen e remitencave sipas vendit të origjinës, sipas së cilës flukset hyrëse janë më të larta nga vendet ku janë të përqëndruar emigrantët kosovarë (figura 6).

Megjithatë, stoku i emigrantëve nuk është i vetmi faktor që përcakton dinamikën e sjelljes së remitencave. Siç duket edhe nga figura 6, megjithëse stoku i emigrantëve nuk ndryshon nga njëri vit në tjetrin, treguesi i remitencave shfaq luhatshmëri më të madhe ndër vite, që mund t'i atribuohet një sërë faktorësh që nuk janë të lidhur me stokun e emigrantëve. Në këtë linjë, ky studim synon të vlerësojë përcaktuesit e flukseve të remitencave në Kosovë, duke u bazuar vetëm në treguesit makroekonomik dhe jo në tregues të natyrës mikro si stoku i emigrantëve, karakteristika të emigrantëve apo të familjarëve të emigrantëve.

Studimi vijon me një përmbledhje të literaturës teorike dhe empirike në lidhje me përcaktuesit makroekonomik, duke u fokusuar edhe në studimet ekzistuese në lidhje me remitencat në Kosovë. Më tej, studimi vazhdon me shtjellimin e bazës së të dhënave, të metodologjisë empirike dhe të rezultateve të përfuara nga kjo metodologji. Pjesa e fundit e studimit ofron disa implikime për politikëbërjen në lidhje me përdorimin e mjeteve apo mënyrave të ndryshme për tërheqjen më të madhe të flukseve të remitencave në Kosovë.

Figura 5. Shpërndarja gjeografike e emigrantëve kosovarë, 2013





Figura 6. Përbërja e Remitencave sipas origjinës



## II. Vështrim mbi literaturën

Pavarësisht rëndësisë së remitencave si një burim i qëndrueshëm dhe i konsiderueshëm në madhësi në rastin e ekonomisë së Kosovës, ekzistojnë shumë pak studime kërkimore në lidhje me faktorët përcaktues të këtyre prurjeve. I vetmi punim i natyrës empirike në lidhje me këtë temë është Havolli (2009), i cili përdor të dhënat mikro të gjeneruara nga një pyetësor i realizuar në vitin 2006 nga Instituti Riinvest në Kosovë. Qëllimi i këtij pyetësori ishte që të grumbullonte informacion nga emigrantët e Kosovës në lidhje me karakteristikat e tyre individuale (mosha, gjinia, arsimimi, statusi civil, numri i viteve të migrimit, informacione në lidhje me familjen e lënë në vendin origjinë) si dhe informacion në lidhje me sasinë e dërguar të remitencave, frekuencën e dërgimit të këtyre transfertave, perceptimin e emigrantëve rreth mjedisit të të bërit biznes në vendin origjinë, etj). Duke përdorur teknika të ndryshme empirike (OLS, Tobit, Probit dhe Ordered Probit), Havolli (2009) gjen se motivi për të investuar dhe perceptimet në lidhje me mjedisin e të bërit biznes në vendin e origjinës janë faktorët përcaktues më të rëndësishëm në vendimin e emigrantëve për të dërguar remitenca. Gjithashtu, studimi gjen se remitenca me kalimin e kohës rriten me një normë ngadalësuese, çka konfirmon ekzistencën e fenomenit të maturitetit në sjelljen e tyre. Një gjetje tjetër e Havolli (2009) është se tek emigrantët kosovarë ekziston aspirata për të trashëguar asetet/pasurinë në vendin origjinë, duke ushtruar kështu ndikim pozitiv në prurjet e remitencave.

Pyetësorë të ngjashëm si ai i Riinvest janë zhvilluar edhe nga UNDP për dy vite radhazi (2010 dhe 2011), të cilat synojnë të ofrojnë një panoramë në lidhje me përdorimin dhe efektet e remitencave në Kosovë dhe të identifikojnë potencialin e kursimit dhe të investimit të emigrantëve kosovarë. Gjetjet kryesore të UNDP (2011), të cilat nuk ndryshojnë shumë nga gjetjet e pyetësorit të mëparshëm, tregojnë se remitenca përdoren kryesisht për qëllime konsumi, e cila mbështetet nga fakti që rreth 90.6 përqind e marrësve të këtyre transfertave rezultojnë se i shpenzojnë në ushqim, veshmbathje, strehim, mallra të qëndrueshme, edukim dhe shëndetësi. Analizat e regresionit kanë treguar se këto remitenca kanë përmirësuar ndjeshëm mirëqenien e përfituesve të këtyre remitencave dhe kanë ndikuar negativisht ofertën e punës së tyre, veçanërisht kur përfituesit e këtyre remitencave janë kryefamiljarë të gjinisë femërore. Pyetësor i UNDP (2011) tregon se familjet që përfitojnë remitenca investojnë vetëm 4 përqind të këtyre transfertave në aktivitete biznesi dhe kursejnë më pak se 4 përqind të tyre. Gjithashtu, pyetësori gjen se numri i emigrantëve që investojnë në Kosovë është i ulët, rreth 35.7 përqind, nga të cilët 60 përqind raportojnë se i investojnë në blerje të pasurive të patundshme për përdorim personal, kurse 23.3 përqind raportojnë se i investojnë në bizneset familjare. Rezultate të ngjashme janë gjetur edhe nga World Bank (2017), sipas së cilës remitenca përbëjnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave për rreth 20- 25 përqind të ekonomive familjare në Kosovë dhe pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave përdoren për qëllime konsumi.

Ekzistojnë dhe një sërë studimesh të tjera në lidhje me remitenca dhe profilin e emigracionit në Kosovë (Kadrijaj dhe Baxhaku, 2013; dhe Zyra Zvicerane për Zhvillim, 2014 ), të cilat janë kryesisht të natyrës përshkruese dhe rekomanduese se si autoritetet përkatëse në Kosovë mund të maksimizojnë ndikimin pozitiv të flukseve hyrëse të remitenca në ekonomi.

I vetmi studim që synon të studiojë përcaktuesit makroekonomik të remitencave në Kosovë është FMN(2013), i cili fokusohet në të dhëna panel për 6 vende të Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Mali i

Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia) gjatë periudhës 1996-2011. Më specifikisht, ky studim kërkon të vlerësojë elasticitetet e dërgesave të emigrantëve ndaj ndryshimit të prodhimit të brendshëm bruto për frymë në vendin pritës dhe origjinë të emigrantëve. Gjetjet kryesore të këtij studimi tregojnë se kushtet ekonomike në vendin pritës luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e flukseve të remitencave. Megjithatë, studimi mbështet edhe ekzistencën e motivit të altruizmit, bazuar mbi shenjën pozitive të diferencës së të ardhurave ndërmjet vendit pritës dhe origjinë të emigrantëve dhe koeficientit negativ të prodhimit të brendshëm bruto në vendin origjinë.

Në këtë linjë, ky studim do të vlerësojë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të remitencave për rastin e Kosovës, duke marrë në konsideratë tregues të vendit të origjinës dhe të vendeve pritëse të emigrantëve në Kosovë. Bazuar mbi gjetjet e këtij studimi, do të ofrohen dhe disa implikime për vendimmarrjen politike në lidhje me tërheqjen dhe përdorimin eficient të këtyre flukseve hyrëse, duke pasuruar njohuritë e deritanishme mbi fenomenin e transfertave të emigrantëve kosovarë. Gjithashtu, ky studim do t'i shërbejë edhe procesit të simulimit dhe të parashikimit me Modelin MakroEkonomik të Kosovës (KMM). Duke qenë se remitencat janë një tregues ekzogjen në model, përcaktimi nga jashtë modelit i faktorëve përcaktues të tyre do të ndihmojë në vlerësimin e saktë të goditjes apo të projeksionit të remitencave, që më tej do të përdoret si input për modelin KMM.

Literatura empirike mbi përcaktuesit makroekonomikë të remitencave ofron gjetje të ndryshme mbi motivimin e mundshëm të emigrantëve për dërgimin e remitencave. Tabit dhe Moussir (2016), duke përdorur të dhëna panel me efekte fikse dhe rastësore për periudhën 1990-2014, vlerësojnë përcaktuesit makroekonomikë të remitencave në një panel prej 22 vendesh, të gjitha të karakterizuara nga një shkallë e lartë varësie nga këto flukse. Gjetjet e studimit tregojnë se përcaktuesit më të rëndësishëm makroekonomikë të remitencave në vendin mikpritës të emigrantëve është prodhimi i brendshëm bruto, inflacioni, zhvillimi financiar dhe cilësia institucionale. Ndërsa, në vendin e origjinës, i vetmi tregues që rezulton i rëndësishëm në përcaktimin e flukseve hyrëse të remitencave rezulton të jetë prodhimi i brendshëm bruto. Në këtë studim, stoku i emigrantëve, kursi zyrtar i këmbimit dhe norma reale e interesit në vendin e origjinës nuk rezultojnë të jenë përcaktues të rëndësishëm statistikisht.

Një studim më i hershëm i realizuar nga Banka Qendrore Evropiane (Schiopu dhe Siegfried, 2006) investigon se cili është motivi kryesor që mbizotëron në vendimin e emigrantëve për të dërguar remitenca në vendin origjinë: motivi i investimit apo i altruizmit. Duke përdorur të dhëna bilaterale për remitenca nga 21 vende të Evropës Perëndimore drejt 7 vendeve fqinje të Bashkimit Evropian, studimi gjen se diferenca ndërmjet prodhimit të brendshëm të vendeve dërguese dhe pranuese të remitencave është i rëndësishëm statistikisht në përcaktimin e sjelljes së remitencave. Ky rezultat mbështetë hipotezën se emigrantët dërgojnë remitenca në vendin origjinë për arsye altruizmi, pra për të ndihmuar financiarisht familjen apo të afërmit e tyre për të përballuar situatat e vështira ekonomike. Gjithashtu, Schiopu dhe Siegfried (2006) gjejnë se diferenca ndërmjet normave të interesit nuk është e rëndësishme statistikisht, duke hedhur poshtë hipotezën e investimit në vendimin e emigrantëve për të realizuar transferta.

Gupta (2006) analizon karakteristikat kryesore dhe faktorët përcaktues të remitencave në Indi, që konsiderohet një prej vendeve me varësinë më të lartë nga remitencat në botë. Studimi përfundon se remitencat në Indi përbëjnë një burim të rëndësishëm financimi, gjë e cila ka ndihmuar ndjeshëm në forcimin e bilancit të pagesave në Indi. Analiza ekonometrike e ndjekur nga Gupta (2006) gjen se aktiviteti ekonomik në vendin pritës ka ndikim pozitiv (dhe statistikisht të rëndësishëm) mbi madhësinë e prurjeve të remitencave, ndërkohë që aktiviteti

ekonomik në vendin origjinë ka ndikim negativ duke mbështetur natyrën kundërciklike të remitencave.

Pjesa më e madhe e studimeve empirike mbi përcaktuesit makroekonomikë të remitencave kryesisht kanë qenë të kufizuara nga mungesa e të dhënave të disagreguara të remitencave, sipas vendit nga të cilat vijnë apo sipas vendit në të cilat këto remitenca dërgohen. Bilanci i Pagesave që prodhon FMN konsiston në të dhëna të agreguara, hyrëse dhe dalëse, për një vend të caktuar por nuk ofron disagregim të këtyre flukseve sipas vendit të origjinës apo të destinacionit. Për të shmangur këtë problem, studime të ndryshme janë fokusuar në një grup të ngushtë të vendeve ku është lokalizuar pjesa më e madhe e diasporës ose dhe në një vend të vetëm. Kurse, studimet të tjera që kanë analizuar flukset hyrëse të remitencave për një panel të madh vendesh i kanë përafruar kushtet ekonomike në vendet mikpritëse të emigrantëve me tregues të natyrës globale, si: çmimet e naftës, prodhimi i brendshëm bruto në botë, LIBOR, etj. Të dyja këto përjasje kanë dobësitë e tyre. Në përjasjen e parë mungon gjithëpërfshirja ndërsa në përjasjen e dytë tregues potencial të rëndësishëm në përcaktimin e sjelljes së remitanacave përafrohen nga tregues të tërthortë. Më konkretisht, problemi në përjasjen e dytë konsiston në faktin se treguesit e natyrës globale, Libor apo prodhimi në botë, mund të bëjnë një punë shumë të dobët në përfaqësimin e mundësive të investimit ose të aktivitetit ekonomik në vendet pritëse të emigrantëve, duke patur parasysh që analiza të Bankës Botërore kanë treguar se në nivel global remitencat e vendeve të Jugut përbëjnë rreth 30- 45 përqind të remitencave të pranuar nga vendet në zhvillim (World Bank, 2006).

Në rastin e Kosovës, siç do të shpjegohet edhe në sesionin vijues, ekzistojnë të dhëna të disagreguara të remitencave sipas vendit të origjinës, gjë e cila shmang përdorimin e treguesve të tërthortë për përafrimin e kushteve ekonomike në vendet pritëse të emigrantëve kosovarë apo lënies jashtë vlerësimeve empirike të vendeve më një numër jo shumë të madh të emigrantëve kosovarë. Më poshtë, gjendet një përshkrim më i detajuar i të dhënave të përdorura në studim dhe i përjasjes metodologjike të ndjekur së bashku me rezultatet e përfutuara prej saj.

### III. Përqaşja metodologjike dhe modeli empirik

Studimi përdor të dhëna tremujore mbi flukset hyrëse të remitencave, të disagreguara sipas vendit nga të cilat origjinojnë, për periudhën 2004-2016. Për periudhën 2004-2008, këto të dhëna janë të disponueshme vetëm në bazë vjetore, dhe për qëllime të studimit janë interpoluar në bazë tremujore duke ruajtur të njëjtën shpërndarje tremujore sikurse në vitin 2009. Të dhënat mbi remitencat përpilohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si shumë e remitencave të kanalizuarra nëpërmjet kanaleve formale (bankat komerciale dhe agjensitë e transferimit të parave) dhe remitencave të dërguara në formë të parave të gatshme (që përbëjnë rreth 40 përqind të atyre të dërguara nëpërmjet kanaleve formale sipas studimit të UNDP-së të realizuar në vitin 2010).

Të dhënat mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto të 15 vendeve, nga të cilat vijnë remitencat, janë me bazë tremujore, të përshtatura sezonalisht, të shprehura me çmimet bazë të vitit 2010 dhe në monedhën Euro. Pavarësisht motivit që mbizotëron tek emigrantët kosovarë, ndikimi i këtij treguesi pritët të jetë pozitiv sepse reflekton mundësitë e punësimit dhe të gjenerimit të të ardhurave më të larta për emigrantët në vendin e huaj.

Kursi bilateral i këmbimit përfaqëson raportin e monedhës së vendit pritës të emigrantëve ndaj monedhës euro (të përdorur në Kosovë) dhe rrjedhimisht një rritje në vlerë e këtij indeksi përfaqëson vlerësim të monedhës euro ndaj monedhës respektive. Indeksi merr vlerën një kur monedha e vendit pritës është euro dhe në këtë mënyrë nuk përbën përcaktues të mundshëm për flukset që vijnë nga ai vend. Nëse tek emigrantët kosovarë do të mbizotëronte motivi i altruizimit, një vlerësim i monedhës euro ndaj monedhave të tjera do të çonte në prurje më të larta të këtyre flukseve me qëllim ruajtjen e të njëjtës fuqi blerëse. Ndërsa, në rastin e një zhvlerësimi të monedhës euro, do të ndodhte e kundërta, pra emigrantët kosovarë do të dërgonin më pak remitenca për të mbajtur të pandryshuar nivelin e të ardhurave për familjarët e tyre në vendin origjinë. Nëse emigrantët kosovarë do të motivoheshin nga kontratat familjare, një mbivlerësim i monedhës Euro do të shkaktonte prurje më të ulta të remitencave sepse emigrantët do të zgjidhnin të dërgonin më shumë remitenca në një kohë të mëvonshme për të shmangur efektin e mbivlerësimit. Ndërsa, në rastin kur emigrantët nxiten nga qëllime të investimit, veçanërisht për investime në pasurinë e patundshme, një mbivlerësim i monedhës Euro do të ndikonte negativisht në prurjet e remitencave dhe anasjellas.

Diferenca e normave të interesit në depozita (ndërmjet normës së vendit pritës të emigrantëve dhe asaj të Kosovës) ka qenë një prej treguesve më problematikë për t'u mbledhur, për shkak të qasjeve të ndryshme metodologjike nga bankat qendrore të vendeve respektive apo institucioneve ndërkombëtare në lidhje me normat e interesit në depozita. Si normë përfaqësuese e normave të interesit në depozita është përdorur norma mesatare e sistemit për depozitat e reja në monedhën vendase (aty ku ka qenë e mundur). Shenja e pritët mbi këtë tregues është e diskutueshme në varësi të motivit që mbizotëron tek sjellja e emigrantëve, në varësi të llojit të investimit për të cilin emigrantët janë më shumë të interesuar të ndërmarrin në vendin origjinë dhe në varësi se çfarë kjo diferencë në norma interesi përfaqëson (perceptim të riskut apo ndryshime të pritura në kursin e këmbimit). Në rastin e mbizotërimit të motivit të altruizimit, diferenca ndërmjet normave të interesit do të ishte e parëndësishme në vendimin e emigrantit për të dërguar remitenca. Por, nëse do të mbizotëronte motivi i investimit, ky tregues do të kishte ndikim negativ për investime financiare dhe ndikim pozitiv për investime në pasuri të patundshme.

Bruto Produkti Vendor në vendin origjinë në terma realë pritët të ketë ndikim pozitiv në prurjet e remitencave nëse mbizotëron motivi i altruizimit, sepse duke qenë edhe në natyrën e llojit të



transfertës, emigranti është i gatshëm të asistojë familjarët kur aktiviteti ekonomik në vendin origjinë përkeqësohet. Ndërsa, kur sjellja e emigrantit dominohet nga motivimi i investimit, ai do të dërgojë më pak remitenca kur aktiviteti ekonomik në vendin origjinë përkeqësohet.

Modeli empirik i përdorur për të modeluar flukset e remitencave nga vendi pritës (j) në Kosovë në kohën  $t$  konsiston në një analizë me të dhëna panel me efekte fikse dhe me efekte rastësore, duke përdorur specifikimin e mëposhtëm në formën e tij më të përgjithshme:

$$rem_{i,t} = \alpha_0 + \alpha_1 * rem_{i,t-1} + \alpha_2 * h\_gdp + \alpha_3 * f\_gdp_j + \alpha_4 * exch_j + \alpha_5 * int\_diff_j + \alpha_6 * trend + \varepsilon_{i,t}$$

ku  $rem_{i,t}$  përfaqësojnë flukset hyrëse të remitencave në Kosovë;  $h\_gdp$  është prodhimi i brendshëm bruto në terma realë në Kosovë;  $f\_gdp$  është prodhimi i brendshëm bruto në vendin ku janë lokalizuar emigrantët kosovarë;  $exch$  është kursi i këmbimit bilateral;  $int\_diff$  përfaqëson diferencën e normës së interesit ndërmjet vendit pritës dhe vendit origjinë; dhe  $trend$  shënon termin kohë.

Specifikimi me efekte fikse lejon “zhveshjen” prej efekteve individuale (të secilit vend), të pandryshueshme në kohë, me qëllimin kryesor të vlerësimit të efektit neto të treguesve shpjegues në treguesin e varur. Supozimi kryesor në specifikimin me efekte fikse është se këto karakteristika individuale dhe që nuk varen nga termi kohë janë unike për individin (vandin në këtë rast) dhe nuk janë të ndërlidhura me karakteristikat individuale të një vendi tjetër. Çdo vend në panel është i ndryshëm dhe rrjedhimisht termi i gabimit dhe konstantja (e cila kap efektet individuale) nuk janë të ndërlidhura me të tjerat. Në rast se konstantja dhe termi i gabimit rezultojnë të ndërlidhura ndërmjet individëve (vendeve), atëherë specifikimi me efekte fikse nuk është ai i duhuri.

Sipas specifikimit më efekte rastësore, variacioni ndërmjet individëve (vendeve në këtë rast) supozohet të jetë rastësor dhe jo i ndërlidhur me treguesit e tjerë shpjegues të përdorur në model. Nëse besojmë se diferencat ndërmjet individëve (vendeve) mund të kenë ndikim në treguesin e varur, duhet të përdorim specifikimin me efekte rastësore. Avantazhi i këtij specifikimi është se lejon përfshirjen e treguesve të pandryshueshëm në kohë si tregues shpjegues, ndërsa në specifikimin me efekte fikse, efekti i këtyre treguesve absorbohet nga termi i konstantes. Në specifikimin me efekte rastësore, duhet që këto efekte individuale të identifikohen, gjë e cila nuk është gjithmonë e mundur dhe kjo mund të çojë në anshmëri që vjen nga ndryshoret (e rëndësishme) të lëna jashtë modelit (*omitted variable bias*).

Nisur nga literatura në lidhje me përcaktuesit makroekonomikë të remitancave, në këtë studim është përdorur specifikimi me efekte fikse. Për të minimizuar problemet e endogjenitetit ndërmjet treguesve, të gjithë treguesit shpjegues që mendohet se mund të ndikohen njëkohësisht nga remitancat dhe gjithashtu të ndikojnë remitencat janë shprehur në vonesat e tyre kohore. Kjo teknikë e eleminon efektin bashkëkohor të remitencave në këta tregues dhe rrjedhimisht shmang anshmërinë që mund të gjenerohet nga bashkëveprimi i tyre. Siç tregon edhe tabela 1, specifikime të ndryshme japin rezultate pak a shumë të ngjashme. Në të gjitha specifikimet, ashtu siç pritej, aktiviteti ekonomik në vendet mikpritëse të emigrantëve del e rëndësishme statistikisht dhe me shenjë pozitive, me një impakt që luhet në intervalin [1.08 përqind: 1.41 përqind], varësisht nga specifikimi i përdorur. Kjo nënkupton që nëse emigrantët janë të

lokalizuar në një vend që karakterizohet nga rritje/përsheptim të aktivitetit ekonomik, ata do të dërgojnë më shumë remitenca si rezultat i rritjes së të ardhurave të tyre ose rritjes së mundësive për punësim për ata emigrantë që janë të papunë në këto vende.

Tabela 1. Rezultatet empirike nga analiza me të dhëna panel

Regresorët	Specifikim (1)	Specifikim (2)	Specifikim (3)	Specifikim (4)
Konstante	-5.8062	-5.7855	-9.6806	-5.0502
( <i>p_value</i> )	0.2738	0.2828	0.1015	0.3582
rems(-1)	0.4721	0.4721	0.4686	0.4702
( <i>p_value</i> )	0.0000	0.0000	0.1015	0.0000
home_gdp(-2)	-0.9337	-0.9339	-0.9251	-0.9268
( <i>p_value</i> )	0.0000	0.0000	0.0000	0.0000
host_gdp(-1)	1.0837	1.0820	1.4112	1.0252
( <i>p_value</i> )	0.0120	0.0134	0.0028	0.0214
exch_rate	-	-	-0.2673	-0.1927
( <i>p_value</i> )	-	-	0.3335	0.4984
int_diff(-2)	-	0.0004	-	-0.0010
( <i>p_value</i> )	-	0.9817	-	0.9558
Trend	0.0059	0.0059	0.0050	0.0057
( <i>p_value</i> )	0.0042	0.0197	0.0848	0.0274
Adj. R-squared	0.8930	0.8928	0.9006	0.8927
FE	Yes	Yes	Yes	Yes

Gjithashtu, pothuajse në të gjitha specifikimet, vonesa e dytë kohore e treguesit të aktivitetit ekonomik në vendin origjinë (Kosovë), ashtu siç sugjeroi edhe analiza e korrelacionit në hyrje të këtij materiali, rezulton të jetë e rëndësishme statistikisht dhe me shenjë negative. Një përkeqësim i aktivitetit ekonomik në vendin origjinë me 1 përqind çon në rritjen e flukseve të remitencave pas dy tremujorëve me rreth 0.93 përqind. Ky rezultat mbështet hipotezën se emigrantët kosovarë motivohen nga altruizimi kur dërgojnë remitenca.

Një gjetje tjetër e rëndësishme është rëndësia statistikore dhe magnituda e konsiderueshme e koeficientit para vonesës së parë kohore të remitancave, gjë e cila konfirmon persistencën në sjelljen e remitencave. Ky rezultat është konsistent edhe me vrojtimin në hyrje të këtij materiali studimor, ku remitancat rezultojnë të jenë flukset më pak të luhatshme krahasuar me burimet e tjera të financimit të huaj.

Ndërsa rezultatet mbi impaktin e kursit të këmbimit sugjerojnë për ekzistencën e motivit të investimit tek emigrantët kosovarë, duke qenë se një vlerësim i monedhës Euro me 1 përqind shkakton prurje më të ulta të remitencave me rreth [0.19 përqind: 0.26 përqind], sipas specifikimit 3 dhe 4 në tabelën 1. Megjithatë, ky ndikim, ndë të dyja specifikimet, rezulton të jetë jo i rëndësishëm statistikisht.

Gjithashtu, treguesi i diferencës së normave të interesit rezulton i parëndësishëm statistikisht në të dyja specifikimet (2 dhe 4), duke mbështetur hipotezën se remitencat dërgohen kryesisht për të plotësuar nevojat konsumit të familjeve të emigrantëve në vendin e origjinës dhe rrjedhimisht nuk përbëjnë një tregues të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë në vendimin e emigrantëve për të dërguar remitanca. Për më tepër, shenja e ndikimit të diferencës së normave të interesit ndryshon nga njëri specifikim në tjetrin.

#### **IV. Konkluzionet dhe implikimet për politikëbërjen**

Qëllimi i këtij studimi ishte të identifikonte përcaktuesit makroekonomikë të remitencave që vijnë në Kosovë, për periudhën 2006 - 2016. Vlerësimi empirik i realizuar me të dhëna në formatin panel për 15 vende nga të cilat remitencat në Kosovë origjinojnë, gjen se remitencat ndikohen nga zhvillimet makroekonomike në Kosovë dhe në vendin ku janë të lokalizuar emigrantët kosovarë.

Konkluzioni më i rëndësishëm i studimit është se aktiviteti ekonomik në vendet mikpritëse të emigrantëve ka ndikim të fortë pozitiv në flukset hyrëse të remitencave, duke dëshmuar kështu për ekzistencën e një kanali tjetër të rëndësishëm nëpërmjet të cilit transmetohen zhvillimet pozitive apo negative nga ekonomitë e huaja në ekonominë e Kosovës.

Një konkluzion tjetër i rëndësishëm është kundër-ciklikaliteti i flukseve të remitencave me aktivitetin ekonomik në Kosovë, çka do të thotë se këto flukse ndihmojnë në zbutjen e goditjeve negative në vend dhe rrjedhimisht tërheqja e tyre në Kosovë duhet të konsiderohet me prioritet nga autoritetet përkatëse. Kjo gjetje gjithashtu mbështet hipotezën se emigrantët kosovarë karakterizohen nga motivi altruist dhe priren të dërgojnë më shumë remitanca tek familjarët e tyre në Kosovë kur situata e tyre financiare përkeqësohet.

Në mbështetje të motivit të altruizimit është edhe fakti që remitencat rezultojnë të jenë mjaft persistente, çka do të thotë se nuk ndryshojnë shumë nga njëra periudhë në tjetrën. Kjo i bën këto flukse të qëndrueshme, çka është shumë e rëndësishme për ato familje për të cilat remitencat përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave.

Ndryshe nga studimi i Havolli (2009), ky studim nuk gjen evidencë empirike se sjellja e emigrantit kosovar në vendimin për të dërguar remitanca tek familjarët e tyre ndikohet nga motivi i investimit. Të dy treguesit e përdorur në studim për përfaqësimin e motivit të investimit, kursi bilateral i këmbimit dhe diferenca e normës së interesit, nuk rezultojnë të jenë përcaktues të rëndësishëm statistikisht në flukset e remitencave hyrëse në Kosovë. Kjo gjetje është në linjë me rezultatet e shumë pyetësorëve të realizuara në Kosovë, sipas të cilave pjesa më e madhe e remitencave përdoret për të mbuluar nevojat e konsumit nga familjarët e emigrantëve. Megjithatë, ky rezultat duhet interpretuar me kujdes dhe në përpjekjet e ardhshme kërkimore duhen të merren në konsideratë tregues të tjerë përafres, të cilët mund të kapin më mirë motivin e investimit tek emigrantët kosovarë.

Si çdo punë kërkimore, ky studim mund të përmirësohet dhe të zhvillohet më tej, në varësi edhe të disponueshmërisë së të dhënave. Përdorimi i një numri më të madh treguesish që përfaqësojnë situatën ekonomike në vendin mikpritës të emigrantëve, në vendin origjinë apo ndërlidhjen ndërmjet vendeve do të përforconte rezultatet më tej ose do të ofronte gjetje të reja mbi përcaktuesit makroekonomikë të remitencave në Kosovë.

**Referencat**

- Bitoulas, 2016, "Population and Social Conditions", Eurostat Data in Focus,
- Eurostat, 2016, "Asylum in the EU Member States", Eurostat NewsRelease, March, Nr. 44
- Gupta, Poonam, 2005, "Macroeconomic Determinants of Remittances: Evidence from India", International Monetary Fund Working Papers, No. 224.
- Havolli, Sokol, 2009, "Determinants of Remittances: The Case of Kosovo", CBK Working Papers, No.3.
- International Monetary Fund, 2013, "Republic of Kosovo: Article IV Consultation", Country Report No.223
- Kadrijaj, Gj., dhe Masar, Baxhaku, 2013, "Analizë mbi Mënyrat e Dërgimit të Remitencave në Kosovë", Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Departamenti i Sistemit të Pagesave.
- Rahman, A., and A. Wadud, 2014, "Macroeconomic determinants of Remittances in South Asian countries: A dynamic Panel Study", Bangladesh Economic Association
- RIINVEST, 2007, "Diaspora dhe Politikat e Migracionit"
- Schiopu, I., and N. Siegfried, 2006, "Determinants of Workers' Remittances: Evidence from the European Neighboring Region", ECB Working Paper Series, No. 688.
- Tabit, S., and Ch. Moussir, 2016, "Macroeconomic Determinants of Migrants' Remittances: Evidence from a panel of Developing Countries", International Journal of Business and Social Research, Volume 06, Issue 07.
- UNDP, 2010, "Studimi i Remitencave në Kosovë"
- UNDP, 2012, "Studimi i Remitencave në Kosovë"
- World Bank Group, 2017, "Country Partnership Framework for the Republic of Kosovo, for the period FY17- FY21"
- World Bank, 2006, Global Economic Prospects: Economic Implications of Remittances and Migration (Washington).
- Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, 2014, "Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë: Migrimi si Forcë për Zhvillim"



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)